

## Raport për rezultatet e konsultimeve publike

### 1. Titulli i draftaktit

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, ‘Për regjistrimin e biznesit’, të ndryshuar

### 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike: 20 ditë Pune, 11.08.2025 - 08.09.2025, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Projektligji synon përafrimin me Direktivën (BE) 2017/1132”.

### 3. Metoda e konsultimit

Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” për periudhën 11.08.2025 - 08.09.2025. Përmes publikimit në RENJK, në zbatim të ligjit 146/2014, janë ftuar qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik.

Projektligji, relacioni shpjegues, RIA dhe Tabela e Përputhshmërisë, janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente.

### 4. Palët e interesit të përfshira

665 vizitorë kanë lexuar projektligjin nëpërmjet RENJKP. Palët e interesit janë qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut.

2 komente janë dërguar nga aktorë të interesuar.

### 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

<b>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</b>	<b>Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</b>	<b>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të</b>	<b>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht /I refuzuar)</b>	<b>Justifikimi</b>
--	---	--	---	--------------------

		<i>ngjashme)</i>		
<p>Përcaktimi i detyrimit për paraqitjen e kartelës së pasurisë për adresat e biznesit dhe verifikimi i përdorimit të ambientit për ushtrim veprimtarie ekonomike.</p> <p>Parandalimi i përdorimit të pronave të destinuara për banim për qëllime biznesi në kundërshtim me destinacionin e regjistruar.</p>	<p>1. Në dokumentet që çdo biznes pamvarsisht nga forma juridike duhet të shtohet dhe një pike ku çdo adrese biznesi duhet të shoqërohet me kartelen e pasurisë në të cilën është e specifikuar përdorimi i ambientit për biznes. Duhet të vendoset fund i përdorimit të pronave të destinuara për banim si prona biznesi</p>	<p>Qytetar Ervin D.</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Propozimi për paraqitjen e detyrueshme të kartelës së pasurisë për çdo adresë biznesi do të shtonte barrën administrative dhe fiskale për subjektet gjatë procedurave të regjistrimit</p>
<p>Trajtimi i ndryshimit të destinacionit të pasurisë të papasqyruar në kartelën e pasurisë si shkelje ligjore.</p>	<p>2. Ndryshimi i destinacionit jo i pasqyruar në kartelen e pasurisë përben shkelje ligjore</p>	<p>Qytetar Ervin D.</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Propozimi do të shtonte barrën administrative dhe fiskale për subjektet gjatë procedurave të regjistrimit</p>